



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 564

Datë: 26.12.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 17, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 10, nenit 19, nenit 46 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.01/440 datë:07.07.2003, kontratës nr.02/401/03 datë:05.09.2003, kontratës nr.02/400/03 datë:05.09.2003, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -XIII- të mbajtur me datë: 21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin e veprimtarisë së punës të SHPK "TIMI" Kosova, Drenofci 5 me pronar Agim Krasniqi nga Fshati Drenoc

1. Miratohet kërkesa nr.02/353 datë: 18.09.2018 e parashtruar nga SHPK "TIMI" Kosova, Drenofci 5 me pronar Agim Krasniqi nga Fshati Drenoc, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e veprimtarisë së punës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi ndërrimi i destinimit të veprimtarisë së punës behët nga fabrika për prodhimin e njehsorëve elektrik në ndërtimin e restaurantit tradicional, zhvillimi i turizmit dhe shumë aktivitetet tjera relaksuese.
3. Sipas kërkesës nr.02/353 datë: 18.09.2018, ndërrimi i destinimit të veprimtarisë së punës bëhet në objektin i cili gjendet në zonën kadastrale në Mirushë në njësinë kadastrale P-72310050-01021-1, vendi i quajtur Lumi-Fusha në sipërfaqe prej 26403 m².
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë të gjitha shkresat përcjellëse.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Gjeodezi, kadastrë dhe shërbim Pronësoro-Juridik.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

MAPL-së

Drejtorive të KK-së

Parashtruesit të kërkesës

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

